



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 40.2 nën (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 dhe nenit 1 deri në 5 të Rregullores për ndarjen e bursave për Studentët e Komunës së Klinës, me propozimin e Drejtorisë së Arsimit, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të të Kuvendit të Komunës së Klinës, të mbajtur me datën 30.11.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentët për vitin akademik 2018/2019

- I. Miratohet Vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës për vitin akademik 2018/2019.
- II. Komisioni i formuar ka këtë përbërje:
 1. Besart Hoti-KK
 2. Enver Gashi-KK
 3. Dafina Bacaj-Ekzekutivi
 4. Binak Sylaj-Ekzekutivi
 5. Vitore Zefi-OJQ "Ardhmëria"
- III. Komisioni bën ndarjen e 20 bursave në lartësi prej 50 € për një student brenda 10 muajve të vitit akademik tetor-qershor 2018/2019.
- IV. Komisioni punon konform Rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës /maji 2016 dhe Rregullores për Ndryshime dhe Plotësime të Rregullores për ndarje të bursave të Komunës së Klinës /mars 2017.
- V. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi i Komunës konform nenit 81 të Ligjit të Vetëqeverisje Lokale 03/L-040.

Me këtë Vendim njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Zyra Ligjore dhe Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe një kopje për Arkivin e Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-0343 2018
Klinë, me 11.12 2018



Kryesuesi,
Fadil Gashi